



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Fusha e zbatimit, juridiksioni dhe kërkesat formale të aplikimit në Procedurën e Urdhrit Evropian për Pagesë (PUEP), si dhe mekanizma të ngjashëm të legjislacionit shqiptar për mbledhjen e detyrimeve

Prof. Assoc. Dr. Flutura Kola Tafaj

Tiranë, 12-13 Dhjetor 2020



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



1. Rregullorja 1986/2006, si akti jo i vetëm ligjor, ndërkufitar për mbledhjen e detyrimeve (borxheve) të pakundërshtuara
2. Qëllimi dhe fusha e zbatimit të Rregullores 1986/2006
3. Përcaktimi i juridiksionit të gjykatave
4. Forma dhe mënyra e aplikimit për lëshimin e Urdhrit Evropian për Pagesë (UEP)
5. Shqyrtimi i aplikimit për UEP
6. Mekanizma të ngjashëm në ligjin procedural shqiptar



1. Rregullorja 1896/2006, si akti jo i vetëm ligjor, ndërkufitar për mbledhjen e detyrimeve (borxheve) të pakundërshtuara

- Rregullorja e Urdhrit Evropian të Ekzekutimit (UEE) Nr. 805/2004
[*Regulation on a European Enforcement Order (EEO) No. 805/2004*]
- Rregullorja e Procedurës së Urdhrit Evropian të Pagesave (PUEP) No.
1896/2006. [*Regulation on a European Order for Payment Procedure
(EOPP) No. 1896/2006*]
- Rregullorja e Procedurës mbi Paditë e Vogla Evropiane (PPVE) No.
861/2007. [*Regulation on European Small Claims Procedure (ESCP) No.
861/2007*]



Rregullorja 1896/2006 u mundëson kreditorëve që të mund të mbledhin detyrime monetare të pakontestuar sipas një procedure unike që funksionon në bazë të formularëve standardë. (7 formularë)

Procedura nuk kërkon prezencë para gjykatës.

Paditësi paraqet vetëm kërkesën dhe procedura vijon në mënyrë të pavarur.

Nuk kërkon ndonjë formalitet ose ndërhyrje të mëtejshme nga ana e paditësit.



2. Qëllimi dhe fusha e zbatimit të Rregullores 1896/2006

- (a) të thjeshtojë, përshpejtojë dhe zvogëlojë kostot e procesit gjyqësor (1) në çështjet ndërkuftare (2) në lidhje me paditë/kërkimet monetare të pakontestuara duke krijuar një procedurë evropiane për pagesa; [PROCESI]

dhe

- (b) të lejojë qarkullimin e lirë të urdhrave evropianë për pagesa në të gjithë Shtetet Anëtare duke përcaktuar standardet minimale, pajtueshmëria me të cilat bën të panevojshme çdo procedurë të ndërmjetme në Shtetin Anëtar të zbatimit para njohjes dhe ekzekutimit. [EKZEKUTIMI I URDHHRIT]



- Territorialisht, Rregullorja është e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare të BE, përvec Danimarkës.
- Rregullorja është e aplikueshme nga data 12 Dhjetor 2008, edhe për çështje të lindura para kësaj datë me kusht që të mos jenë parashkruar.
- Procedura e përcaktuar nga kjo Rregullore - mjet shtesë dhe opsional për paditësin, i cili mbetet i lirë të përdorë një procedurë të parashikuar nga ligji kombëtar.
- Rregullorja as nuk zëvendëson as harmonizon mekanizmat ekzistues për mbledhjen e borxheve (detyrimeve) të pakontestuar sipas ligjit kombëtar. (Preambul 10)



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



- Rregullorja zbatohet për çështjet civile dhe tregtare ndërkufitare.
- Rregullorja NUK shtrihet, në veçanti, te të ardhurat, çështjet doganore ose administrative ose përgjegjësia e Shtetit për veprimet dhe mosveprimet gjatë ushtrimit të autoritetit shtetëror (*'acta iure imperii'*).



- **Cështje civile dhe tregtare** – Rregullorja nuk ka përkufizim.
- GjED: “..termit "çështje civile dhe tregtare" duhet t'i jepet një kuptim autonom që rrjedh nga objektivat dhe skema e legjislacionit të Komunitetit dhe parimet e përgjithshme që qëndrojnë në themel të sistemeve ligjore kombëtare si një e tërë (*C-29/76 LTU Lufttransportunternehmen GmbH & Co KG v Eurocontrol, ECR 1976, 1541*).
- GjED: “dy elemente janë të rëndësishëm për të vendosur nëse një mosmarrëveshje është e një natyre civile dhe tregtare:
 - lloji (lënda) i mosmarrëveshjes; dhe
 - natyra e marrëdhënies midis palëve të përfshira.



- Në lidhje me paditë që përfshijnë një autoritet publik, GjED shprehet se: “një çështje nuk është "civile ose tregtare" kur ka të bëjë me një mosmarrëveshje midis një autoriteti publik dhe një personi privat kur i pari vepron në ushtrimin e pushtetit publik.
- GjED bën dallimin midis *acta iure imperii*, të cilat janë të përjashtuara nga nocioni i "çështjeve civile ose tregtare", dhe *acta iure gestionis*, të cilat përfshihen në një nocion të tillë.
- Dallimi midis *acta iure imperii* dhe *acta iure gestionis* nuk është gjithmonë i lehtë në praktikë.



- Shembuj nga praktika e GjED në lidhje me dallimin mes midis *acta iure imperii* dhe *acta iure gestionis*:
- Në çështje *Préservatrice foncière* (C-266/01), Gjykata vendosi që nocioni "çështje civile ose tregtare" e përfshin një padi me të cilën një shtet kërkon të zbatohet kundër një personi privat, një kontratë garancie ligjore e cila është lidhur për të mundësuar një person të tretë të sigurojë një garanci të kërkuar dhe të përcaktuar nga ai Shtet, për atë që sa marrëdhënia juridike midis kreditorit dhe garantuesit, sipas kontratës së garancisë, nuk përfshin ushtrimin nga shteti i kompetencave që shkojnë përtej atyre që ekzistojnë sipas rregullave të zbatueshme për marrëdhëniet midis individëve private.
- Në çështjen *Eurocontrol*, GjED u shpreh se një pretendim i një autoriteti publik, i bazuar në një traktat ndërkombëtar, për të rimarrë shpenzimet për përdorimin e pajisjeve dhe shërbimeve të saj kur një përdorim i tillë ishte i detyrueshëm dhe shpenzimet ishin përcaktuar në mënyrë të njëanshme nuk është çështje civile ose tregtare.



- Rregullorja NUK zbatohet për:
 - (a) të drejtat mbi pronën që lindin nga një marrëdhënie martesore, testament dhe trashëgimi;
 - (b) falimentimi, procedurat në lidhje me likudimin e shoqërive tregtare ose personave të tjerë juridikë, rregullimet gjyqësore, përbërjet dhe procedurat analoge;
 - (c) sigurimet shoqërore;
 - (d) pretendimet që rrjedhin nga detyrimet jashtëkontraktore, përveç nëse:
 - (i) ato kanë qenë objekt i një marrëveshje midis palëve ose ka pasur një pranim të borxhit, ose
 - (ii) ato kanë të bëjnë me borxhe të likuiduara që vijnë nga pronësia e përbashkët e pronës.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Për qëllim të kësaj Rregulloreje, një çështje ndërkufitare është ajo në të cilën të paktën njëra nga palët ka vendbanimin ose vendqëndrimin e zakonshëm në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga Shteti Anëtar i gjykatës së investuar.

Paditësi & i Padituri – persona të BE-së

Paditësi – Person Jo-BE-së (Shqiptar)/ I Padituri – person i BE-së

Paditësi – Person i BE-së/I Padituri – Person jo i BE-së (Shqiptar)



- Vendbanimi përcaktohet në përputhje me nenet 59 dhe 60 të Rregullores së Brukselit Nr. 44/2001 (22 Dhjetor 2000) “Mbi juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare”.
- Neni 59 “1. Në mënyrë që të përcaktohet nëse një palë e ka vendbanimin në Shtetin Anëtar, gjykatat e të cilit janë investuar për një çështje, gjykata do të zbatojë ligjin e saj të brendshëm. 2. Nëse një palë nuk e ka vendbanimin në Shtetin Anëtar, gjykatat e të cilit janë investuar për çështjen, atëherë, për të përcaktuar nëse pala është me vendbanim në një Shtet tjetër Anëtar, gjykata do të zbatojë ligjin e këtij Shteti Anëtar.
- Neni 60: “1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, një kompani ose person tjetër juridik ose shoqatë e personave fizikë ose juridikë është me vendbanim në vendin ku ka:
 - (a) selinë statutore, ose
 - (b) administratën qendrore, ose
 - (c) vendin kryesor të biznesit ”.”



- Momenti përkatës për të përcaktuar nëse ekziston një çështje ndërkufitare do të jetë koha kur aplikimi për një Urdhër Evropian për Pagesë dorëzohet në përputhje me këtë rregullore.
- Vendbanimi dhe vendqëndrimi i paditësit do të përcaktohet nga gjykata në bazë të të dhënave në aplikimim e bërë nga paditësi. Gjykata ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga Paditësi nëse ka dyshime në lidhje me vërtetësinë e informacioneve të dhëna. (guide)
- Procedura e UEP-s zbatohet për mbledhjen e detyrimeve pasurore për një shumë të përcaktuar që është bërë e kërkueshme në kohën kur paraqitet kërkesa për UEP. (n. 4)



3. Përcaktimi i juridiksionit të gjykatave

- Për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, juridiksioni do të përcaktohet në përputhje me rregullat përkatëse të ligjit të Komunitetit, në veçanti të Rregullores (KE) Nr. 44/2001 me një përjashtim:
- Nëse kërkesa ka të bëjë me një kontratë të lidhur nga një person, konsumatori, për një qëllim që mund të konsiderohet se është jashtë tregtisë ose profesionit të tij, dhe nëse i padituri është konsumator, vetëm gjykatat në Shtetin Anëtar në të cilin i padituri e ka vendbanimin, në kuptim të nenit 59 të Rregullores (KE) nr. 44/2001, do të ketë juridiksion.
- Preambula (12) “Kur vendosin se cilat gjykata duhet të kenë juridiksion për të lëshuar një urdhër evropian për pagesë, shtetet anëtare duhet të marrin parasysh nevojën për të siguruar aksesin në drejtësi.”



- Për të përcaktuar nëse ka ose jo juridiksion gjykata mbështet në të dhënat e paraqitura nga aplikanti.
- Nëse aplikanti jep të dhëna të gabuara???? (*Thomas Cook Belgjikë*, C-245/14, EU:C:2015:715. (n. 16)
- Po nëse aplikanti jep të dhëna të sakta por gjykata i vlerëson gabimisht? (n. 16 dhe n. 20)



- Pika 16 e Preambulës: Gjykata duhet të shqyrtojë kërkesën, përfshirë çështjen e juridiksionit dhe përshkrimin e provave, në bazë të informacionit të dhënë në formularin e aplikimit. Kjo do të lejojë gjykatën të shqyrtojë prima facie bazueshmërinë e padisë dhe ndër të tjera të përjashtojë padi qartazi të pabazuara ose kërkesa të papranueshme. Nuk është e nevojshme që shqyrtimi të bëhet nga një gjyqtar.
- Pika 17 e Preambulës: Nuk do të ketë të drejtë ankimi kundër mospranimit të kërkesës. Kjo nuk përjashton, një rishikim të mundshëm të vendimit të mospranimit të kërkesës në të njëjtën shkallë në përputhje me ligjin kombëtar.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



- European Judicial Atlas
- https://e-justice.europa.eu/content_european_payment_order-353-en.do?clang=en
- Nëse aplikimi dërgohet në gjykatën jo-kompetente- ligji kombëtar i vendit ku ndodhet gjykata është i aplikueshëm.



4. Forma dhe mënyra e aplikimit për lëshimin e UEP-s

- Aplikimi për UEP bëhet sipas një formulari standard A.
- Aplikimi duhet të tregojë:
 - a. **emrat dhe adresat e palëve** dhe, kur është e zbatueshme, përfaqësuesit e tyre dhe të gjykatës në të cilën është bërë kërkesa;
 - b. **vlerën e padisë**, duke përfshirë principalin dhe, kur është e zbatueshme, interesin, gjobat kontraktuale dhe kostot;
 - c. nëse kërkohet interes për padinë, **norma e interesit dhe periudha kohore për të cilën kërkohet ai interes**, përveç nëse interesi ligjor automatikisht i shtohet principalit sipas ligjit të Shtetit Anëtar të origjinës; (jo interes të ardhshëm)
 - d. **shkakun ligjor**, duke përfshirë një përshkrim të rrethanave ku bazohet padia dhe, kur është e zbatueshme, dhe interesi i kërkuar;
 - e. një përshkrim të **provave** ku mbështetet padia;
 - f. **arsyet e juridiksionit**;
 - g. natyrën **ndërkufitare** të çështjes.



- Pika 14 e Preambulës së Rregullores: “Në këtë kontekst, duhet të jetë e detyrueshme që paditësi të përfshijë një përshkrim të provave që mbështesin padinë. Për këtë qëllim, formulari i aplikimit duhet të përfshijë një listë sa më shteruese të llojeve të provave që zakonisht paraqiten në mbështetje të pretendimeve pasurore.”
- Në lidhje me kostot – neni 25 i Rregullores së UEP-it
- Aplikimi duhet plotësuar në gjuhën e vendit ku ndodhet gjykata e investuar.



- Në aplikim, paditësi deklaron që informacioni i dhënë është i vërtetë me sa ka njohuri dhe pranon që çdo deklaratë e qëllimshme e rreme mund të çojë në penaltete të përshtatshme sipas ligjit të Shtetit Anëtar të origjinës.
- Paditësi mund t'i tregojë gjykatës cilën, nëse ka, nga procedurat e renditura në pikat (a) dhe (b) të Nenit 17 (1) ai kërkon të zbatohet për padinë e tij në procesin civil vijues në rast se i padituri paraqet një deklaratë kundërshtimi kundër Urdhrit Evropian për Pagesë.
- Paditësi mund t'i tregojë gjykatës që ai kundërshton transferimin në proces civil brenda kuptimit të pikës (a) ose pikës (b) të nenit 17 (1) në rast të kundërshtimit nga i padituri. Kjo nuk e ndalon paditësin ta informojë gjykatën për këtë më vonë, por në çdo rast para se të lëshohet urdhri.



- Aplikimi paraqitet në formën e një dokumenti të shkruar ose me ndonjë mjet tjetër komunikimi, përfshirë elektronik, të pranuar nga Shteti Anëtar i origjinës dhe i disponueshëm për gjykatën e origjinës.
- Aplikimi do të nënshkruhet nga paditësi (ose përfaqësuesi). Kur aplikimi paraqitet në formë elektronike në përputhje me paragrafin 5, ai do të nënshkruhet në përputhje me nenin 2 (2) të Direktivës 1999/93 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 Dhjetorit 1999 mbi kuadrin Komunitar për nënshkrimet elektronike (1). Nënshkrimi do të njihet në Shtetin Anëtar të origjinës dhe nuk mund t'u nënshtrohet kërkesave shtesë.
- Për qëllime të kësaj Direktive: “nënshkrimi elektronik i avancuar” nënkupton një nënshkrim elektronik i cili përmbush kërkesat e mëposhtme:
 - (a) lidhet me nënshkruesin në mënyrë unike;
 - (b) ka aftësinë të identifikojë nënshkruesin;
 - (c) krijohet me mjete të cilat mund t'i mbajë nën kontroll vetëm nënshkruesi; dhe
 - (d) lidhet me të dhënat me të cilat ka të bëjë në mënyrë të atillë që të mund të jetë i diktueshëm çdo ndryshim i mëpasshëm i këtyre të dhënave;



5. Shqyrtimi i aplikimit për UEP

- Gjykata e investuar me një aplikim për një urdhër evropian për pagesë shqyrton, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në bazë të formularit të aplikimit, nëse kërkesat e përcaktuara në nenet 2, 3, 4, 6 dhe 7 janë përmbushur dhe nëse pretendimi duket se është i bazuar. Ky ekzaminim mund të marrë formën e një procedure të automatizuar.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



- Nëse kërkesat e përcaktuara në nenin 7 nuk plotësohen dhe nëse pretendimi është qartazi i pabazuar ose aplikimi është i papranueshëm, gjykata do t'i japë kërkuarit mundësinë për të plotësuar ose korrigjuar kërkesën. Gjykata do të përdorë formularin standard B.
- Kur gjykata kërkon që paditësi të plotësojë ose korrigjojë aplikimin ajo do të specifikojë një afat kohor që e konsideron të përshtatshëm sipas rrethanave. Gjykata, sipas gjykimit të saj, mund ta zgjasë atë afat.



5. Mekanizma të ngjashëm sipas legjislacionit shqiptar

- Ligji 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare
- Neni 16 “Titulli ekzekutiv”: “1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:
 - a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe
 - b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.”



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



FALEMINDERIT!